



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:097548

Datë: 02.07.2021

Numri i dokumentit: 01952436

PKR.nr.356/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Alltën Murseli, me bashkëpunëtore profesionale Fatime Shabani, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit A.K, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I.nr.354/21, të datës 11.06.2021, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 16.06.2021, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i shtetit Bashkim Zeqaj, i akuzuari A.K, dhe mbrojtësi i tij av. Qazim Qunaku, të njëjtën ditë, me datë 16.06.2021, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: **A.K**, nga babai S. dhe nëna F., e vajzërisë M, i lindur me datë “ data e lindjes”, me vendbanim ne rr. “D..” II nr..... Fushë Kosovë, me numër personal “ numri personal”, i pa martuar, ka të kryer shkollën e fillore, i papunësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pa dënuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: I akuzuari pa autorizim, shet substanca, të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, në atë mënyrë që me datën 20.05.2021, rreth orës 21:45, në Fushë Kosovë, në rr. “N....”, në lokalit “S...Sh....”, pronari i lokalit D.H kishte njoftuar policinë se dy persona po konsumojnë substancë narkotike, me pas policia ka shkuar në lokalit dhe ka hasur në të akuzuarin A.K, dhe të miturin A.S në lokal, ku i akuzuari A. i kishte shitur të miturit një qese të substancës narkotike të llojit marihuan me peshe 0.40 gram, në shumën prej 2 euro, dhe më pas, gjatë kontrolles sipërfaqësore ne trupin e të akuzuarit policet kane gjetur 10 qese me substance të dyshuar narkotike të llojit marihuan me peshë 8.48 gram, të cilat kane qenë të destinuara për shitje,

-me këtë, ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 KPPRK-së, të akuzuarin:

E GJYKON

I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Dënim me gjobë në shumën prej 500.00 (pesëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I njëjti dënimin e shqiptuar me gjobë mund të paguaj, me dy këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që t'ia paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20.00 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit i konfiskohen një qese të substancës narkotike të llojit marihuan me peshe 0.40 gram, dhe 10 qese me substance të dyshuar narkotike të llojit marihuan me peshë 8.48 gram, e cila është si rezultat i kryerjes së veprës penale.

ARSYETIMI

Prokuroria Themelore në Prishtinë Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.354/21, të datës 11.06.2021, e ka akuzuar A.K, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 16.06.2021, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari A.K, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, si dhe ka shtuar se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit dhe se këtë pranim e ka bërë vullnetarisht.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.K, Av. Qazim Qunaku deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që konsideroj që në këtë rast janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në prova të prezantuar nga ana e prokurorit të shtetit gjatë fazës hetimore duke u bazuar në fakte të theksuar si mbrojtës i të akuzuarit e kam këshilluar të akuzuarin që ta pranojë fajësinë lidhur me veprën penale në mënyrë që i akuzuari në këtë rast të përfitoj nga favorët ligjore mbi bazën e institutit juridik që ka të bëjë me zbutjen e dënimit në rastin e matjes dhe caktimit të dënimit nga gjykata. Prandaj duke pas parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese i propozoj gjykatës që me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit sipas nenit 69 të KPRK-së, ta këtë parasysh mundësin e zbutjes së dënimit në përputhje me nenin 71 dhe 72 të KPRK-së, gjithashtu i propozoj gjykatës që në rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit të këtë parasysh rrethanat lehtësuese si në vijim: moshën e re të të akuzuarit, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, shprehjen e keqardhjes dhe të pendimit të thellë si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën e njëjtë apo ndonjë vepër tjetër penale, gjithashtu i propozoj gjykatës që ta këtë parasysh dhe statusin ekonomik, respektivisht gjendjen ekonomike të dobët dhe në veçanti ta këtë parasysh edhe faktin se në bazë të bisedave që kam zhvilluar me të akuzuarin kohët e fundit i akuzuari ka një ofertë punë dhe i njëjti zotohet se do të kthehet jetës normale, familjes dhe punës, dhe asnjëherë në të ardhmen nuk do të përsërisë një vepër të tillë apo të ngjashme. Sa i përket propozimi të prokurorit të shtetit lidhur me vazhdimin e masës së arrestit

shtëpiak si mase për sigurimin e prezencës së të akuzuarit gjykatës i propozoj që këtë masë të zëvendësoj me masën alternative nga nenin 173 të KPPRK-së, paraqitje në Stacion Policor.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që i njëjti është në përputhshmëri me dispozitat ligjore, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese dhe lehtësuese gjykatës i propozoj që si rrethane rënduese të merr parasysh shitjen e narkotikut, në rastin konkret një të mituri, ndërsa si rrethane lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ndërsa sa i përket propozimit për mase tani e tutje këtë propozim e le në vlerësim të gjykatës pasi që kushtet për të cilat është kërkuar vazhdimi i masës së arrestit shtëpiak kanë pushur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit përveç rrezikut të përsëritjes së veprës penale, për çka kërkoj nga gjykata që ta vlerësoj sipas detyrës zyrtare.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, kryetari i trupit gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe në konsultim të mjaftueshëm me avokatin dhe është e mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuzën, e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga deklaratat e të akuzuarit dhënë në polici dhe prokurori, procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit D.H, procesverbali i marrjes në pyetje A.S, vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve të sekuestruara të të akuzuarit 2021-AE-0662, të dt. 20.05.2021, raporti i ekspertizës i testit laboratorik me numër 2021-AE-0662, raporti i policit R.L, si dhe foto dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: sjelljen e mëparshme të të akuzuarit; pranimin e fajit dhe sinjeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar, si dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, ndërsa gjykata si rrethanë veçanërisht rënduese mori faktin se i akuzuari i ka shitur narkotik të miturit, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi mbi konfiskimin e sendit që përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 267 par. 5 të KPK.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale, gjykata ka vendosur në përputhje me nenin 450 par.2 të KPPRK-së.

Numri i lëndës: 2021:097548
Datë: 02.07.2021
Numri i dokumentit: 01952436

Nga sa u tha më lart në bazë të neneve 366 par. 3 të KPK(kodi nr.04/L-123) u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi..

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.356/21, datë 16.06.2021

Bashkëpunëtore profesionale,
Fatime Shabani

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Alltën Murseli

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.